



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE PUNËSIMIT  
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL

Nr. 460 Prot.

Tiranë, më 10/1 /2023

**UDHËZIM**

Nr. 1, datë 10.1.2023

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E PROGRAMEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL QË  
PËRFITOJNË NGA MBËSHTETJA FINANCIARE, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 2 pika 2 e Kreut I, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 5.10.2022 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private",

**UDHËZOJ:**

1. Të përfitojnë nga mbështetja financiare për vitin 2023, programet e formimit profesional në fushën "Programim".
2. Në fushën "Programim" përfshihen: kodimi, programimi kompjuterik, zhvillimi i aplikacioneve, robotika, elektronika, shkenca e të dhënave, siguria kibernetike, inteligjenca artificiale, testimi i software-ve, dizajni i software-ve, dizajni i faqeve web, dizajni i përvojës së përdoruesit, dizajni i ndërfaqes së përdoruesit, mësimi makinerik/automatik, realiteti i shtuar, realiteti virtual ose algoritmet kompjuterike apo fusha të ngjashme të tjera.
3. Fondet për zbatimin e këtij programi për vitin 2023 të mbulohen nga fondet e lira të programit të nxitjes së punësimit.
4. Udhëzimi nr. 29 datë 27.10.2022 "Për përcaktimin e programeve të formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare, për vitin 2022, shfuqizohet.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

